




HARTA E PROBLEMATIKAVE VENDORE NË 27 NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË TIRANË

Mars 2022



www.PerQytetin.com

❖❖ CFARË ËSHTË NISMA ❖❖ “PËR QYTETIN”?

Një konsorciumi organizatash të udhëhequra nga Qëndresa Qytetare e cila synon të rrisë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen e Këshillave Bashkiake Tiranë, Durrës dhe Kurbin duke fuqizuar qytetarët, organizatat dhe grupet e interesit për të të luajtur një rol aktiv në përcaktimin e përparësive zhvillimore të komunitetit dhe territorit ku ato banojnë apo punojnë duke ndërmarrë peticione dhe iniciativa elektronike. Kjo nismë mbështetet nga Lëviz Albania dhe SDC në Shqipëri.



Në thelb të kësaj nisme e është nxitja e ushtrimit të të drejtave ligjore të parashikuara në nenin 19 dhe 20 të ligjit 139/2015 për Vetqeverisjen Vendore të cilat garantojnë zbatimin e detyrimeve ligjore të bashkisë dhe rrisin cilësinë e qeverisjes. Gjithashtu demokracia vendore pasurohet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesit në qeverisjen vendore dhe më së pari mundësohet nga qeverisja e mirë vendore.

Për Qytetin Vendos ti

Ne synojmë nxitjen dhe forcimin e demokracisë vendore dhe inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Bashkisë, si dhe në influencimin e axhendën qeverisëse të Bashkisë.

❖❖ SI JANË MBLEDHUR TË DHËNAT E ❖❖ HARTËZUARA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE?

Qëndresa Qytetare zhvilloi një pyetësor në 3 bashkitë e përfshira në këtë nismë, **Tiranë, Durrës dhe Kurbin** ku u pyetën **600 qytetarë**. Intervistuesit u lokalizuan në të gjitha njësitë administrative të bashkive për të komunikuar me banorët mbi problematikat që ata hasin. Të dhënat u mbledhën në rrugë digjitale, u përpunuan dhe u paraqitën në formën e hartës e cila shoqëron këtë material.

Ekipi i Qëndresës realizoi një verifikim faktesh të dytë duke fotografuar nga afër një pjesë të problematikave që shprehën banorët e këtyre njësisve administrative.



❖❖ KUJT I SHËRBEJN HARTA E ❖❖ PROBLEMATIKAVE VENDORE?

Harta e problematikave vendore

Së pari: i shërben Këshillave Bashkiake dhe administratës së 3 bashkive për t'u njohur me shqetësimet e banorëve sipas zonave të tyre dhe për ti adresuar ato kryesisht, bazuar në detyrat dhe funksionet që u jep ligji për vetqeverisjen vendore.

Së dyti: harta i shërben organeve vendore për të ndërtuar planet strategjike, për të organizuar dëgjесat publike dhe buxhetin vendor.


Së treti: kjo hartë i shërben organizatave pjesë e konsorciumit dhe grupimeve të tjera qytetare për të ngritur në nivel advokimi dhe lobimi fushatat e tyre për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e fokusit drejt problemeve të qytetarëve. Gjithashtu harta do të jetë një pikënisje për peticionet dhe iniciativat që do ti drejtohen Këshillave Bashkiake nga organizatat pjesë të këtij konsorciumi.



◆◆ CFARË MENDOJNË BANORËT PËR ◆◆ PETICIONET DREJTUAR KËSHILLIT BASHKIAK?

Banorët e intervistuar u pyetën edhe mbi adresimet që i kanë bërë këtyre problematikave dhe gatishmërinë që kanë për t'ju drejtuar bashkisë me kërkesa apo ankesa konkrete.

44% e banorëve shprehen se i janë drejtuar për problemet lokale më parë Administratorit të nënsisë vendore, por nuk kanë marrë mbrapsht një trajtim për problemin e caktuar.



89% e tyre nuk kanë marrë as përgjigje nga strukturat lokale.



◆◆ CILAT JANË PROBLEMATIKAT KRYESORE ◆◆ NË ZONAT URBANE TË BASHKISË TIRANË??



Nisur nga përgjigjet e intervistës së qytetarëve dhe verifikimet në vend nga ana e ekipit të Qëndresës Qytetare zonat urbane në kryeqytet vuajnë **problematikat e ujit të pijshëm**, i cili vjen me orare dhe jo në nivelin e duhur të pastërtisë për tu konsumuar, sidomos në njësitë 1 dhe 3 në kryeqytet.




Një problem tejet shqetësues për banorët janë edhe **mungesa e trotuareve** në rrugët e qytetit, e cila bëhet shpesh herë edhe burim aksidenti duke ulur sigurinë dhe cilësinë e jetesës së tyre. Kjo problematikë është më e theksuar në njësitë 12 dhe 14 në kryeqytet.




Mungesa e vendeve të parkimit dhe shpeshtësia e gjobave nga policia bashkiake është një tjetër problem që shqetëson banorët e Tiranës.

Rreth **75%** e banorëve të Bashkisë Tiranë janë të gatshëm të nënshkruajnë një **peticion** për problematikë e adresuara në hartën vendore duke menduar se edhe komuniteti që vuan të njëjtën problematikë do ti bashkohet këtij peticioni.



60% e banorave të intervistuar besojnë tek peticionet online dhe kanë shprehur gatishmëri për tu bërë pjesëmarrës ose iniciatorë në këto peticione drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë.





- Njësia Administrative Nr. 1**
1. Furnizimi me ujë nuk është 24 orë
 2. Shkollat janë pa ngrohje



- Njësia Administrative Nr. 2**
1. Mungon ndriçimi në lagje dhe sinjalistika rrugore
 2. Rrugë pa sinjalistikë dhe të ndotura



- Njësia Administrative Nr. 3**
1. Uji i pijshëm është i ndotur dhe me orare
 2. Mungesa e hapësirave në varrezat publike



- Njësia Administrative Nr. 4**
1. Ndriçimi i rrugëve brenda lagjeve dhe infrastruktura e tyre
 2. Nuk realizohet siç duhet shërbim i largimit të mbetjeve



- Njësia Administrative Nr. 5**
1. Infrastruktura e rrugëve e pamundurëson ndërhyrjen e zjarfikëseve
 2. Rrugët e lagjeve janë të amortizuara, me mbetje dhe baltë



- Njësia Administrative Nr. 6**
1. Nuk realizohet siç duhet shërbim i largimit të mbetjeve
 2. Transportit publik me vonesa në stacione



- Nj. Administrative Nr. 7**
1. Mungojnë vendet e mjaftueshme të parkimit për qytetarët.
 2. Gjambat e shpeshta nga policia bashkiake për parkime

- Nj. Administrative Nr. 8**
1. Trotuare të ngushta, mungon infrastruktura rrugore në lagje



- Nj. Administrative Nr. 9**
1. Mbeturina të shumta në lagje dhe rrugë që nuk largohen



- Nj. Administrative Nr. 10**
1. Mungon ndriçimi në lagje & rrugë
 2. Mungojnë vendet e parkimit për qytetarët

- Nj. Administrative Nr. 11**
1. Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve sidomos në brendësi të tyre
 2. Infrastruktura dhe sinjalistika rrugore


- Nj. Administrative Nr. 12**
1. Mungesa e trotuareve, duke vënë në rrezik jetën e qytetarëve



- Nj. Administrative Nr. 13**
1. Transportit publik me vonesa në stacione dhe mbipoullim në urbane.
 2. Sistemet kulluese i pa rehabilituara



- Nj. Administrative Nr. 14**
1. Mungesa e ndriçimit të rrugëve dhe e trotuareve
 2. Mungesa e vendeve të parkimit për qytetarët





Kashar

1. Mungon ndriçimi në lagje dhe sinjalistika rrugore.
2. Transportit publik me vonesa në stacione dhe mbipoullim në urbane.



Ndroq

1. Mungesa e strehimiti dhe rehabilitimit pas problemeve të tërmetit



Vaqarr

1. Mungon furnizimi me ujë të pijshëm në disa fshatra
2. Mungon ndriçimi në lagje dhe sinjalistika rrugore



Pezë

1. Mungon furnizimi i vazhdueshëm me ujë dhe sinjalistika rrugore



Baldushk

1. Mungon trajtimi i ujrave të ndotura, banesat furnizohen me ujë të papijshëm



Zall Her

1. Mungesa e koshave të mbeturinave dhe trajtimit të mbetjeve



Zall Bastar

1. Infrastruktura rrugore e dobët, Ura e Zall Bastarit në emergjencë



Dajt

1. Mungesa e tualeteve në shkollë 9 Vjeçare, Dajt
2. Mungesa e Qendrave sociale dhe kulturore për fëmijë dhe të moshuar



Farkë

1. Probleme me sigurinë publike, vidhen stolat
2. Mungojnë trotuarët në disa lagje dhe nivel i lartë i ndotjes



Shëngjergj

1. Keqmenaxhimi i zjarreve në pyjet e Shëngjergjit



Krrabë

1. Largësia nga shërbimet vendore dhe papunësia e banorëve




Bërzhitë

1. Mungojnë sistemet e ujitjes dhe kullimit



Petrelë

1. Mungesa e infrastrukturës rrugore





Njësia Administrative Nr. 1 ka një popullsi prej 52 138 banorësh dhe 17 954 familjesh. Kjo njësi ka në territorin e saj 120 rrugë të emërtuara, afërsisht 1 500 biznese private, 15 shkolla, 3 qendra shëndetësore dhe disa institucione të rëndësishme publike. Në njësinë 1 u intervistuan 10 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Furnizimi me ujë të pijshëm, i cili vjen me orare dhe nuk është 24 orë. Gjithashtu uji ka problem në pastërtinë e tij për t'u konsumuar.
2. Shkollat publike që ndodhen në këtë njësi, janë pa ngrohje, sipas banorëve të zonës.

Cit. nga banorët ... "Uji ikën gjatë ditës në intervale të ndryshme kohore."...



Njësia Administrative Nr. 2 ka rreth 81.195 banorë dhe 28.709 familje. Në këtë njësi ndodhen 24 institucione të arsimit parauniversitar dhe 82 administratore pallatesh të regjistruar. Në njësinë 2 u intervistuan 13 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Mungesa e ndriçimit në lagje e cila sjell problematika për banorët, sidomos për sigurinë e tyre dhe sinjalistika rrugore e paplotësuar.
2. Rrugë të ndotura dhe mungon gjelbërimi në lagje

Cit. nga banorët ... "Ndriçimi zero, si me qenë në fshat"...



Njësia Administrative Nr. 3 ka një popullsi prej 45 227 banorësh dhe 16 576 familjesh. Në këtë njësi ndodhen 15 institucione arsimore parauniversitare, disa tregje dhe njësi të shërbimit vendor. Në njësinë 3 u intervistuan 9 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Furnizimi me ujë të pijshëm, i cili vjen me orare . Gjithashtu uji ka problem në pastërtinë e tij për t'u konsumuar. E njëjta situatë është edhe me ujrën e ndotura të cilat kur bie shi përmbysin pusetat dhe dalin në sipërfaqe.
2. Mungesa e hapësirave në varrezat publike

Cit. nga banorët ... "Ska hapësirë në varrezat publike, mbetën tu u varros 4 veta në 1 vend"...



Njësia Administrative nr. 4 ka një popullsi prej 64 733 banorësh dhe rreth 22 481 familjesh. Në këtë njësi operojnë rreth 150 biznese dhe 16 institucione të arsimit parauniversitar. Në njësinë 4 u intervistuan 7 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Ndriçimi i rrugëve brenda lagjeve dhe infrastruktura e tyre është problematike me gropa dhe asfalt të dëmtuar.
2. Nuk realizohet siç duhet shërbimi i largimit të mbetjeve.

Cit. nga banorët ... "Koshat rinë të tejmbushur dhe mbetjet përhapen në lagje"...





Njësia Administrative Nr. 5 është njësia me numrin më të madh të banorëve, 85 579 banorë dhe 30 741 familje. Në territorin kësaj njësie ka 20 institucione të arsimit parauniversitar dhe 6 njësi të shërbimit qytetar.

Në njësinë 5 u intervistuan 16 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Infrastruktura e rrugëve e cila e pamundëson ndërhyrjen e zjarrfikëseve në raste emergjente
2. Rrugët e lagjeve janë të amortizuara, me mbetje dhe baltë shprehen banorët.

Cit. nga banorët ... "Plehra kudo që shkel"...



Njësia Administrative Nr. 6 e quajtur ndryshe si Kombinati, ka 77 620 banorë dhe 26 140 familje. Në këtë njësi ndodhen 14 institucione të arsimit parauniversitar.

Në njësinë 6 u intervistuan 9 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Nuk realizohet siç duhet shërbimi i largimit të mbetjeve në vend depozitime
2. Transportit publik me vonesa në stacione dhe mbipopullim të urbanëve



Njësia Administrative Nr. 7 ka në territorin e saj 74,552 banorë dhe rreth 27,780 familje. Në këtë njësi ka në total 19 institucione të arsimit parauniversitar dhe 123 administratorë pallati të regjistruar. Në njësinë 7 u intervistuan 11 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Mungesa e vendeve të mjaftueshme të parkimit për qytetarët në lagje dhe rrugët kryesore të njësisë.
2. Gjobat e shpeshta nga policia bashkiake për parkime gjatë ditëve të javës.

Cit. nga banorët ... "parkojnë betoniere dhe makina marerialesh ndërtimi kudo dhe nuk kemi vend, janë zaptuar të gjitha nga ndërtuesit"...



Njësia Administrative Nr. 8 ka 41 421 banorë dhe 14 751 familje. Në këtë njësi operojnë 1223 biznese dhe janë të vendosur 8 objekte të arsimit parauniversitar. Sipërfaqja e territorit të kësaj njësie është 1.75 km².

Në njësinë 8 u intervistuan 7 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë:

1. Trotuare të ngushta, mungesë infrastrukture rugore dhe ndricimi në lagje



Njësia Administrative Nr. 9 ka 64 014 banorë dhe 24 296 familje. Në këtë njësi operojnë 2186 biznese private dhe janë të vendosura 16 institucione arsimore. Njësia Administrative nr.9 është e përbërë nga lagjet me të vjetra autoktone tiranase.

Në njësinë 9 u intervistuan 9 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mbeturinat e shumta në lagje dhe në rrugë që nuk largohen prej ditësh.

Cit. nga banorët ... "Mbeturinat ne lagje bëhen grumbull dhe vijnë erë të keqe"...



Njësia Administrative Nr. 10 ka 27 731 banorë dhe 11 176 familje. Në këtë njësi ndodhen 7 institucione arsimore dhe sipërfaqja e saj është 1.9km2.

Në njësinë 10 u intervistuan 6 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungon ndriçimi në lagje dhe rrugë, banorët shprehën gjithashtu se trotuaret janë të ngushta.
2. Mungojnë vendet e parkimit për qytetarët dhe mungesa e qendrave sociale shihet si një problem më vete.

Cit. nga banorët ... "Kam djalin e verbër dhe nuk ka institucione që mund ta shkolloj"...



Njësia Administrative Nr. 11 me qendër të saj Laprakën ka 65 056 banorë dhe 21 429 familje. Në këtë njësi operojnë 2000 biznese dhe janë të vendosura 15 institucione arsimore.

Në njësinë 11 u intervistuan 7 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve sidomos në brendësi të tyre
2. Infrastruktura dhe sinjalistika rrugore



Njësia Administrative Nr. 12 është relativisht një njësi e vogël me 15 669 banorë dhe 5229 familje. Në këtë njësi ndodhen vetëm 2 objekte arsimore dhe vetëm 7 administratorë pallatesh të regjistruar.

Në njësinë 12 u intervistuan 5 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e trotuareve, duke vënë në rrezik jetën e qytetarëve
2. Mungesa e Qendrave sociale për fëmijë ose të moshuar dhe mungesa e infrastrukturës në objektet arsimore.

Cit. nga banorët ... "Kopshti ka shkallet pa mbajtse dhe janë rrezik"...



Njësia Administrative Nr. 13

përfshin zonën e selitës dhe kodrës së diellit dhe ka vetëm 13 000 banorë dhe 4662 familje.

Në njësinë 13 u intervistuan 4 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Transportit publik me vonesa në stacione dhe mbipoullim në urbane.
2. Sistemet kulluese të pa rehabilituara



Njësia Administrative Nr. 14

përfshin zonën e Yzberishit dhe Asirit dhe ka rreth 70 000 banorë.

Në njësinë 14 u intervistuan 7 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e ndricimit të rrugëve dhe e trotuareve
2. Mungesa e vendeve të parkimit për qytetarët



Njësia Administrative Dajt

ka rreth 22 000 banorë dhe 6300 familje. Në këtë njësi administrative operojnë 813 biznese dhe ndodhen 11 atraksione turistike. Kalaja e Dajtit është shpallur monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1963 dhe dëshmon për popullimin e hershëm të kësaj zone.

Në njësinë Dajt u intervistuan 6 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e tualeteve në shkolla 9 Vjeçare, Dajt
2. Mungesa e Qendrave sociale dhe kulturore për fëmijë dhe të moshuar



Njësia Administrative Farkë

ndodhet 7 kilometër në juglindje të Tiranës dhe ka 17 894 banorë dhe 5250 familje. Në Farkë operojnë 971 biznese dhe ka 5 atraksione turistike.

Në njësinë Farkë u intervistuan 5 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Probleme me sigurinë publike, vidhen stolat e parkut të liqenit.
2. Mungojnë trotuaret në disa lagje dhe nivel i lartë i ndotjes është problem shqetësues për banorët.

Cit. nga banorët ... "Ndotja aq keq sa nuk kalohet"...



Njësia Administrative Vaqarr ka 10 423 banorë dhe 2849 familje të vendosura në të. Në Vaqarr operojnë 445 biznese dhe janë 9 institucione arsimore që ushtrojnë veprimtarinë. Vaqarri shtrihet në jug perëndim të Tiranës rreth 6 km larg saj.

Në njësinë Dajt u intervistuan 4 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungon furnizimi i regullt me ujë të pijshëm në disa fshatra
2. Mungon ndriçimi në lagje dhe sinjalistika rrugore

Cit. nga banorët ... "Na mungon ngrohja në kopshtin e fëmijëve"...



Njësia Administrative Kashar ka 37 373 banorë dhe 11 285 familje. Territori i Kasharit shtrihet në të dy anët e autostradës Tiranë- Durrës. Në këtë aks operojnë bizneset më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare. Paralel me autostradën shtrihet linja hekurudhore për transport publik dhe mallrash. Në njësinë Dajt u intervistuan 6 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e ndriçimit në lagje dhe sinjalistika rrugore. Edhe ndotja shihej si një tjetër problem nga banorët e intervistuar.
2. Transporti publik karakterizohet nga me vonesa në stacione dhe mbipoullim në urbane.



Njësia Administrative Pezë ndodhet rreth 12 km larg kryeqytetit, ka 5855 banorë dhe afro 1658 familje që banojnë në të. Numri i bizneseve që operojnë në këtë njësi është 133.

Në njësinë Pezë u intervistuan 4 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:


1. Furnizimi jo i vazhdueshëm me ujë të pijshëm
2. Sinjalistika rrugore



Njësia Administrative Baldushk shtrihet në jugperëndim të Tiraëns dhe ka një numër prej 5329 banorësh dhe 1587 familjesh.

Në njësinë Baldushk u intervistuan 4 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungon trajtimi i ujrave të ndotura, banesat furnizohen me ujë të papijshëm
2. Infrastruktura e dobët rrugore pamundëson një cilësi të mirë jetese



**Njësia Administrative Shëngjergj**

ndodhet 40 kilometër në lidnje të qytetit të Tiranës dhe ka në total vetëm 2594 banorë dhe 984 familje.

Në njësinë Shëngjergj u intervistuan 3 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Largësia nga shërbimet administrative në bashki
2. Gjatë periudhës së verës zjarret e rëna në këtë njësi janë keqmenaxhuar duke shkaktuar djegien e pyjeve, kullotave dhe ndotjen e ajrit përreth.

**Njësia Adminsitrative Zall Bastar**

ndodhet 18 kilometra larg prej Tiranës, përbëhet nga 12 fshatra dhe ka 5337 banorë dhe 1840 familje.

Në njësinë Zall Bastar u intervistuan 3 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Infrastruktura rrugore e dobët, momentalisht Ura e Zall Bastarit në emergjencë.

**Njësia Adminsitrative Zall Her**

ndodhet 15 kilometër larg qytetit të Tiranës dhe ka 11 900 banorë dhe 3480 familje. Në këtë zonë operojnë rreth 138 biznese, si edhe ka 10 institucione arsimore.

Në njësinë Zall Her u intervistuan 4 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e koshave të mbeturinave dhe trajtimit të mbetjeve
2. Infrastruktura rrugore e dobët.

**Njësia Adminsitrative Bërzhitë**

ndodhet 16 kilometër në juglindje të qytetit të Tiranës dhe ka në total 5891 banorë dhe 1826 familje. Në këtë zonë operojnë rreth 108 biznese.

Në njësinë Bërzhitë u intervistuan 3 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e sistemeve të ujitjes dhe kullimit
2. Largësia nga shërbimet administrative në qendër të bashkisë






Njësia Adminsitrative Krrabë

shtrihet mes rrjedhës së lumënjve Erzen dhe Shkumbin, ka vetëm 3065 banorë dhe 1517 familje. Në këtë zoën operojnë vetëm 60 biznese.

Në njësinë Krrabë u intervistuan 3 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Largësia nga shërbimet vendore në Tiranë
2. Papunësia e lartë e banorëvetë fshatrave përbërëse të njësisë adminsitrative



Njësia Adminsitrative Ndroq është

një urë lidhëse mes Durrësit dhe Tiranës, ka 9356 banorë dhe 2571 familje. Në këtë zonë operojnë rreth 136 biznese.

Në njësinë Ndroq u intervistuan 3 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Infrastruktura e dobët rrugore.
2. Mungesa e strehimiti dhe rehabilitimit pas problemeve të tërmetit



Njësia Adminsitrative Petrelë

ndodhet 12 kilometër në juglindje të Tiranës dhe ka 6587 banorë dhe 1878 familje. Në këtë zonë operojnë rreth 138 biznese lokale.

Në njësinë Petrelë u intervistuan 3 banorë të cilët shprehën shqetësimet e tyre mbi problematikat vendore, që rezultojnë të jenë kryesisht:

1. Mungesa e infrastrukturës rrugore, e cila është më e theksuar në zonat në brendësi të fshatrave.





Qendresa Qytetare

HARTA E PROBLEMATIKAVE, TIRANE



Per Qytetin Vendosi

QytetarIN RRETH NESH PETICIONI INICIATIVA QYTETARE KESHILLI BASHKIAK AKTIVITETE

MERR PJESË NË PETICION

RITJIA E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

PETICION/ INICIATIVA Elektronike

Demokracia digjitale në nivel vendor www.p... Watch Later Share

Watch on YouTube

ANËTARËT KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONET KESHILLI BASHKIAK

VENDIMET KESHILLI BASHKIAK

LIGJ NR. 199/2019 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

LAJMI I FUNDIT

Qendresa Qytetare dhe Durrësi Aktiv nismë të përbashkët Për Qytetin

Peticione/ Iniciativa të realizuara

Peticion/ Initiative Aktive

Nis një Peticion ose Initiative

Shkarko Aplikacionin

Google Play

HARTA E PROBLEMATIKAVE DHE NEVOJAVE EMERGJENTE PËR NËNDERHYJE NË NIVEL VENDOR

www.perqytetin.com



Nis një peticion ose Iniciativë

*Ju mungojnë shërbimet dhe infrastruktura në lagjen tuaj?
Doni të propozoni një akt që sjell ndryshim në bashkinë tuaj?
Besoni se keni mbështetjen e komuniteti që ju rrethon?
Qendresa Qytetare ju inkurajon t'i drejtoheni Këshillit Bashkiak me Peticione dhe Iniciativa Qytetare për çështje që ju shqetësojnë dhe që lidhen me qytetin ku banoni*

Për Qytetin Vendosi

Për Qytetin



Qëndresa
Qytetare



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC